

REPUBLIKA E KOSOVËS
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
KOMISIONI PËR TRAJNIME

**Raport i Vlerësimit të
Nevojave për Trajnim të
Vazhdueshëm për
Gjyqtarët e
Departamentit Special
në Kuadër të Gjykatës
Themelore në Prishtinë**

Prishtinë, tetor 2023

Përmbajtja:

Hyrje.....	2
Fushëveprimi i Departamentit Special	3
Rezultatet e studimit.....	3
PJESA I – STATISTIKA.....	4
PJESA II – AFTËSI TË PËRGJITHSHME.....	5
PJESA III – AFTËSI TË VEÇANTA & NJOHURI	9
PJESA IV – METODOLOGJIA E TRAJNIMIT	12
IV.1. Lloji më i përshtatshëm i trajnimit për të arritur rezultatet më të mira në nxënie	12
IV.2. Profili i trajnuesit më i përshtatshmi për të ofruar trajnimin e kërkuar.....	14
IV.3. Kohëzgjatja më efikase e një trajnimi dhe specifikat tjera të trajnimit.....	16
PJESA V - CILËSIA DHE RËNDËSIA E TRAJNIMIT	19
PJESA E VI - NEVOJAT INDIVIDUALE PËR TRAJNIM	22
VI.1. Trajnime e ndjekura nga koha kur shërbeni në Departamentin Special	22
VI.2. Trajnimet që u nevojiten në vendin e punës	22
VI.3. Kategoria e veprave penale deri më tani keni qenë të ngarkuar me punë.....	22
REKOMANDIME	23

Në vend të parathënies

Themelimi dhe funksionalizimi i Departamentit Special në Gjykatën Themelore në Prishtinë kishte për qëllim *inter alia* që çështjet para saj të trajtoheshin në nivelin më të lartë të kompetencës profesionale. Përveç që ky departament trajton çështjen me rëndësi dhe me impakt publik të veçantë, njëkohësisht paraqet ndjeshmërinë më të madhe nga të gjitha aspektet që reflektojnë funksionet gjyqësore në një shoqëri demokratike. Andaj, Departamenti Special do të duhej të ketë prioritet të lartë të trajtimit në të gjitha aspektet, përfshirë edhe atë të trajnimeve.

Qëllimi i përgjithshëm i këtij vlerësimi është identifikimi i nevojave të gjyqtarëve që shërbejnë në Departamentin Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, për trajnim të vazhdueshëm.

Ky dokument duhet të shërbejë si bazë për Akademinë e Drejtësisë gjatë zhvillimit të programeve të trajnimit, për trajnim të vazhdueshëm, që grupi i gjyqtarëve që janë vlerësuar për këto nevoja trajnuese në këtë njësi organizative, ta kenë maksimalisht në konsideratë këtë vlerësim dhe në përputhje të plotë me këto gjetje, të ofrojnë edhe trajnimet.

Ky dokument si produkt final, por edhe dokumentet tjera parapërgatitore që kanë qenë bazë e hartimit të këtij raporti, janë hartuar dhe përgatitur nga z. Vilard Bytyqi, kryetar i Komisionit të Trajnimeve. Raporti në versionin e draft-raportit është diskutuar në takimet e Komisionit të Trajnimeve. Me datë 5 dhe 6 tetor 2023, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka organizuar punëtori të veçantë me pjesëmarrje të gjerë, përfshirë anëtarët e KGJK-së, kryetarët e gjykatave, gjyqtarë, Drejtori dhe përfaqësues të Akademisë së Drejtësisë, ku mes tjerash është bërë shpallja e këtij dokumenti.

Për pjesën teknike të dokumentit është kujdesur z. Enver Beha nga njësia e IT në SKGJK-së, ndërsa koordinimin, administrimin dhe mbledhjen e të dhënave të studimit e ka bërë sekretarja e Komisionit të Trajnimeve, znj. Mersime Mehmeti.

Para se tu dërgohet për ty plotësuar pjesa e pyetësorit, kryetari dhe sekretarja e komisionit kanë mbajtur takim me kryetaren e GJTH në Prishtinë, znj. Albina Shabani Rama dhe me shumicën e gjyqtarëve të Departamentit Special, me qëllim të sqarimit të qëllimit dhe metodologjisë së këtij studimi. Gjithashtu, sekretarja e komisionit ka qenë në dispozicion të vazhdueshëm të gjyqtarëve për t'i udhëzuar në plotësimin e formularit të pyetësorit.

Me respekt!

Prishtinë, tetor 2023

Prof. Asoc. Dr. Vilard Bytyqi

Kryetar – Komisioni i Trajnimeve

Fushëveprimi i Departamentit Special

Departamenti Special është organizuar dhe funksionalizuar sipas Rregullores Nr. 03/2019 për Organizimin dhe Funksionalizimin e Departamentit Special në Kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit të miratuar më 23 prill 2019 nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Shkalla e Parë e Departamentit Special është njësi organizative që vepron në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe ka kompetencë të shqyrtojë lëndët të cilat bien në kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, në pajtueshmëri me Ligjin për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, përfshirë plotësim-ndryshimet e këtij ligji bazik. Departamenti Special në kuadër të Gjykatës së Apelit vepron sipas ankesës së parashtruar nga palët e autorizuar kundër vendimeve të Departamentit Special që vepron në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, e të cilat janë

Rezultatet e studimit

Qëllimi i studimit ishte të paraqiste perceptimin e përgjithshëm të gjyqtarëve që shërbejnë në departamentin Special në kuadër të GJTH në Prishtinë kundrejt nevojave shtesë të trajnimit. Për këtë arsye, është hartuar një pyetësor për t'i vlerësuar këto nevoja.

Pyetësori u hartua në pesë fushë, përkatësisht: Pjesa I – statistika; Pjesa II – Aftësi të Përgjithshme; Pjesa III – Aftësi të veçanta & njohuri; Pjesa IV – Metodologjia e trajnimit; Pjesa V - Cilësia dhe rëndësia e trajnimit dhe Pjesa e VI - Nevojat individuale për trajnim. Secila fushë ka pasur pyetjet e veçanta, ku shumica nga të cilat kanë qenë pyetje të mbyllura me disa alternativa të përgjigjeve.


Në anketim kanë marrë pjesë të gjithë gjyqtarët e Departamentit Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, përkatësisht 10 gjyqtarë, aq sa është numri aktual i tyre që janë pjesë aktive e departamentit.

PJESA I – STATISTIKA

I.1. Shumica e gjyqtarëve që shërbejnë në Departamentin Special, janë gjyqtarë me përvojë, pasi shumica nga ta kanë mbi 10 vite pune në sistemin gjyqësor.

1. Sa përvojë keni si gjyqtar?


10 responses



I.2. Shumica e gjyqtarëve që shërbejnë në Departamentin Special, kanë pothuajse vite të njëjta të përvojës së punës në këtë njësi, pasi kjo njësi edhe ashtu është themeluar rishtas, pra në vitin 2019 dhe tek në vitin 2020 ka filluar së funksionalizuar në tërësi. Andaj, kontingjenti i përgjithshëm i gjyqtarëve në këtë departament kanë pothuajse të njëjtat vite të shërbimit në këtë njësi, rrjedhimisht nuk kemi gjyqtarë të rinjë, apo me përvojë në këtë departament që mund të binin kontradikta të caktuara brenda për brenda kolegëve.

2. Prej sa kohësh punoni në DS të GJ.TH. Prishtinë?

10 responses




PJESA II – AFTËSI TË PËRGJITHSHME

Tek pjesa e renditjes së rëndësisë së temave të ardhshme që duhet të trajtoheshit gjyqtarët e DS për aftësi të përgjithshme, më e preferuara – më e nevojshme për ta ka qenë aftësia lidhur me marrëdhënie me publikun, pastaj aftësi komunikimi dhe aftësi gjuhësore (gjuhë angleze), e më pak të preferuara kanë qenë Marrëdhënie ndër-personale, Aftësi të menaxhimit të kohës, Menaxhimi i stresit, Menaxhim të zyrës dhe Aftësi të IT-së.


Aftësi komunikimi

10 responses




Marrëdhënie me publikun

10 responses




Marrëdhënie ndër-personale

10 responses




Aftësi të menaxhimit të kohës

10 responses




Aftësi gjuhësore (anglisht)

10 responses




Menaxhimi i stresit

10 responses




Menaxhim të zyrës

10 responses



Aftësi të TI - së

10 responses




PJESA III – AFTËSI TË VEÇANTA & NJOHURI

Tek pjesa e renditjes së rëndësisë së temave të ardhshme që duhet të trajnoheshit gjyqtarët e DS për aftësi të përgjithshme, më e preferuara – më e nevojshme për ta ka qenë: Risitë në legjislacion; Jurisprudenca e Gj.E.D.Nj.- zhvillimet e fundit; Jurisprudenca e Gjykatës Supreme– zhvillimet e fundit; Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese – zhvillimet e fundit; Të drejtat e njeriut dhe aftësi të rëndësishme sociale. Ndërsa më pak të preferuara për tu trajnuar kanë qenë: Hulumtimi ligjor; Aftësi në përpilimin e arsytimit dhe aktgjykimit dhe Integriteti & etika gjyqësore.


Risitë në legjislacion

10 responses




Jurisprudenca e Gj.E.D.Nj.- zhvillimet e fundit

10 responses




Jurisprudenca e Gjykatës Supreme– zhvillimet e fundit

10 responses




Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese – zhvillimet e fundit

10 responses




Të drejtat e njeriut dhe aftësi të rëndësishme sociale

10 responses




Hulumtimi ligjor

10 responses




Aftësi në përpilimin e arsytimit dhe aktgjyqimit

10 responses



Integriteti & etika gjyqësore

10 responses



PJESA IV – METODOLOGJIA E TRAJNIMIT


IV.1. Lloji më i përshtatshëm i trajnimit për të arritur rezultatet më të mira në nxënie

Tek pjesa e metodologjisë së zhvillimit të trajnimeve, shumica e gjyqtarëve janë përgjigjur se preferojnë më së shumti takimet e drejtpërdrejta me gjyqtarëve e shkallëve më të larta gjyqësore, e të cilat mund të organizohen në formë të tryezave apo seminareve, nga ku diskutohen çështjet konkrete nga perspektiva e zbatimit të ligjit.

Diskutimet në kolegjiunin e Departamentit Special, gjithashtu është një nga preferencat e gjyqtarëve, e të cilat janë shprehur në shkallë 4 dhe 5 të preferencës, përkatësisht 7 nga 10 sa janë gjithsejtë. Trajnimet në Akademi të Drejtësisë, nuk janë në mesin e trajnimeve të cilat tanimë preferojnë gjyqtarët, kjo sigurisht për shkak të kohës së gjatë të kaluar në ambiente të këtij institucioni dhe vazhdimësisë së ofertës që ka Akademia vit pas viti. Ndërsa më pak të preferuarat janë trajnimet online dhe trajnimet në vendin e punës.


Trajnimet në Akademi

10 responses




Diskutim në kolegjiunin e DS

10 responses




Trajnimet në vendin e punës

10 responses




Takimet me shkallët më të larta gjyqësore

10 responses



Trajnimet online


10 responses




IV.2. Profili i trajnuesit më i përshtatshmi për të ofruar trajnimin e kërkuar

Për të anketuarit, *trajnuesi më i përshtatshëm për trajnimin e tyre, është një ekspert i jashtëm*. Pastaj janë gjyqtarët dhe prokurorët. Dhe më pak të preferuar janë trajnuesit nga Akademia dhe profesorët universitar. Kur mendohet eksperti i jashtëm, është fjala për kategorinë e personave që kanë një ekspertizë përtej të zakonshmes, dhe kanë kompetencë të lartë profesionale dhe kanë aftësi të veçanta për të ndihmuar edhe vijuesit e trajnimit. Tek ekspertët e jashtëm në këtë rast, mendohet kategoria e personave që kanë qenë në pozita të rëndësishme apo ende janë në to, sikurse janë vendet e Evropës Perëndimore, apo SHBA-ve, pastaj nga gjykatat ndërkombëtare penale, apo institucioneve tjera me renome.

Trajnues nga Akademia e Drejtësisë
10 responses




Gjyqtar/Prokuror
10 responses




Profesor universitar

10 responses



Ekspert i jashtëm

10 responses




IV.3. Kohëzgjatja më efikase e një trajnimi dhe specifikat tjera të trajnimit

Shumica e gjyqtarëve tek pjesë e kohëzgjatjes së trajnimit se sa ditë do të jenë efikase për tu arritur qëllimi i trajnimit, janë përgjigjur se trajnimet duhet të jenë më të gjata dhe me ditë të pashkëputura, pra, ata preferojnë që trajnimet të jenë së paku 5 ditë. Rrjedhimisht, supozohet se ata preferojnë që trajnimet të mos jenë të parcializuara në ditë dhe të shpërndara përgjatë gjithë vitit, dhe të interferojnë në ditët e tyre të punës, pasi shkëputja nga vendi i punës dhe shkuarja në Akademi, për ta është një kosto shtesë e pasivizimit të punës dhe ri-futjes në trajnime, e të cilat nganjëherë mund edhe të mos jenë shumë të dobishme për shumë arsye. Të gjithë gjyqtarët (10) preferojnë që trajnimet të mbahen në sistemin block, d.m.th. të pandara.


Për shkak të dhënies së përparësisë së angazhimeve profesionale dhe të punës, gjyqtarët kanë preferuar që trajnimet të organizohen edhe gjatë fundjavës, d.m.th. jashtë ditëve të punës.

Gjyqtarët, që të gjithë preferojnë që trajnimet të mbahen të përbashkëta, me gjithë sistemin e drejtësisë penale, përkatësisht me zyrtarë policor, prokurorë dhe bashkëpunëtor profesional.

Gjysmë dite
10 responses




Një ditë
10 responses




Dy ditë

10 responses




Më shumë

10 responses




A preferoni që sesionet trajnuese të mbahen në sistemin bllok, apo të shpërndara gjatë gjithë vitit?

10 responses




A do të dëshironit që të merrnit pjesë në trajnime gjatë fundjavës?

10 responses



A do të dëshironit që të merrni pjesë në trajnime të përbashkëta (zyrtarë policor, prokurorë, bashkëpunëtor profesional)?

10 responses



PJESA V - CILËSIA DHE RËNDËSIA E TRAJNIMIT

Lidhur me cilësinë e trajnimeve të deritanishme, shumica janë përgjigjur se janë të kënaqur, por jo edhe në masë të madhe. Pra, pritjet për trajnime më cilësore janë ende evidente.

Lidhur me fushat ku janë trajnuar, shumica janë të kënaqur, ndërsa një pjesë nuk është e sigurt se u ka shërbyer nevojave reale në vendin e punës.

Trajnimet e vazhdueshme për shumicën e gjyqtarëve janë të rëndësishme, pasi shumica e tyre e kanë vlerësuar në shkallën 4 apo 5.


Nga përgjigjet e dhëna, shumica e gjyqtarëve veçse janë pjesë aktive e pjesëmarrjes në trajnime të vazhdueshme.

Shumica e gjyqtarëve janë tejet të interesuara të ndjekin kurse të reja trajnimi.

Lidhur se a duhet të jenë obliguese trajnimet për gjyqtarë, përgjigjet janë të ndara përgjysmë, nga ku gjysma mendon se duhet, ndërsa gjysma tjetër nuk është e sigurt. Vetëm 20% mendon se nuk duhet.


Si e vlerësoni cilësinë e trajnimit që keni ndjekur më parë?

10 responses




A i është përgjigjur trajnimi i ofruar deri tani nevojave tuaja reale?

10 responses



Sa i rëndësishëm është trajnimi i vazhdueshëm për kryerjen e detyrave tuaja?

10 responses




Kur ka qenë hera e fundit që keni marrë pjesë në një trajnim?

10 responses




Sa i interesuar jeni për të ndjekur kurse të reja trajnimi?

10 responses



A duhet të bëhet i detyrueshëm ndjekja e kurseve të trajnimit?

10 responses



PJESA E VI - NEVOJAT INDIVIDUALE PËR TRAJNIM

VI.1. Trajnime e ndjekura nga koha kur shërbeni në Departamentin Special

Shumica janë përgjigjur se kanë ndjekur trajnime nga fushat sikurse në vijim:

- Pastrimi i parave;
- Financimi i terrorizmit;
- Krime lufte;
- Krimi kibernetikë;
- Korrupsion;
- Krim i organizuar;
- Konfiskim i aseteve;
- Krime ekonomike;
- Menaxhim i zyrës;
- Shkrim e arsytim ligjor;
- Etikë profesionale;
- Përdorim i platformës HELP;
- Përdorim i platformës HUDOC;
- Përdorim i mekanizmave rezidual në krime lufte;
- Provat dhe pranueshmëria e tyre;
- Terrorizëm;
- Pjesëmarrje në luftërat e huaja;
- Risitë e Kodit te Procedurës Penale.

VI.2. Trajnimet që u nevojiten në vendin e punës

Shumica janë përgjigjur se *i duhen trajnime në fushat të cilat deri më tani i kanë ndjekur, përkatësisht i duhen trajnime më të specializuara dhe më të avancuara*. Gjithashtu, shumica preferojnë një trajnim lidhur me praktikën e Gjykatës Supreme lidhur me zbatimin e dispozitave të Kodit të Ri Penal të Kosovës dhe Kodit të ri të Procedurës Penale. Si dhe më shumë trajnime lidhur me veprat penale që hyjnë në kompetencë të Departamentit Special, e veçanërisht pastrim parash.

VI.3. Kategoria e veprave penale deri më tani keni qenë të ngarkuar me punë

Të gjitha gjyqtarët janë përgjigjur se janë të ngarkuar me të gjitha veprat penale të të gjitha natyrave të cilat janë në kompetencë të këtij departamenti. Rrjedhimisht, i duhet trajnim për të gjitha fushat që bie nën fushëveprimin e Departamentit Special.

Për t'iu përgjigjur nevojave që kanë gjyqtarët e Departamentit Special në kuadër të GJTH në Prishtinë, me qëllim që puna dhe performanca e tyre të jetë me kompetencë të lartë profesionale në të gjitha aspektet, dhe që gjyqtarët të promovojnë standardet më të larta etike që forcojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor, rekomandimet e mëposhtme janë disa nga masat që duhet adresuar nga Akademia e Drejtësisë sikurse në vijim:

REKOMANDIME

1. Akademia e Drejtësisë **duhet të hartojë kurrikula të veçanta trajnuese** për të gjithë zyrtarët e zbatimit të ligjit të shërbejnë në sistemin e drejtësisë penale që kanë ndërlidhje substanciale me kompetencat e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, rrjedhimisht Departamentit Special në kuadër të GJTH në Prishtinë dhe të Apelit. Por edhe për zyrtarët policor dhe pjesëmarrësit e tjerë që marrin pjesë në ndonjë nga stadet e procedurës penale sipas Kodit të Procedurës Penale;
2. **Kurrikulat trajnuese duhet të bazohen në trajnime fillestare** me rastin e zgjedhjes, apo caktimit në këto njësi, përkatësisht **edhe trajnime të vazhdueshme**, e të cilat ndërlidhen me fushat e përgjithshme apo të veçanta që i ndihmojnë, apo i formojnë më tutje me kompetencë të specializuar;
3. Trajnimet duhet të kenë theks të veçantë për krimet e luftës, e veçanërisht në plotësim-ndryshimet e reja të cilat janë përfshirë në Kodin e Procedurës Penale. **Një nga teknikat trajnuese duhet të jetë vizita studimore në institucionet ndërkombëtare**, sikurse janë gjykatat ndërkombëtare penale, apo edhe disa nga vendet të cilat kanë pasur sistem gjyqësor që në përvojat e tyre kanë gjykuar së fundmi krimet e luftës. Shembull i tillë mund të jetë Kroacia, apo BeH;
4. **Akademia duhet të marrë në konsideratë preferencat e gjyqtarëve të DS**, sikurse janë ato për formim dhe zhvillim të aftësive të përgjithshme, apo edhe të atyre specifike, e që ndërlidhen me zhvillimin dhe avancimin e aftësive për jurisprudencën e GJEDNJ, Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës Supreme, risitë në legjislacion dhe të tjera;

5. Akademia duhet të bëjë përpjekje maksimale, qoftë edhe përmes donatorëve, **të sjellë ekspertë të njohur dhe të shquar në fushat specifike që mbulon DS** dhe gjyqtarët e të marrin trajnimet e duhura për zhvillimin dhe avancimin e kompetencave profesionale;
6. **Sistemi i trajnimit duhet të jetë njëkohshëm – block**, d.m.th. pa shpëputje gjatë vitit, apo edhe i ndarë në dy turne trajnuese sipas nevojës, qoftë edhe në ditë vikendi. Gjithashtu, Akademia duhet të iniciojë me shpejtësi diskutimet ndërmjet shkallëve gjyqësore për jurisprudencën e gjykatave dhe adresimin e tyre përmes tryezave profesionale, apo seminareve të ndryshme;
7. **Trajnimet duhet të jenë të specializuara dhe të përshtatura për Departamentin Special**. Por megjithatë, ky nuk duhet të jetë *sistem vakumi*, por duhet të jenë i analizuar dhe i përshtatur edhe me specifikat që i bartë sistemi në përgjithësi, pasi dispozitat procedurale janë të njëjtat për faktin se është një ligj i zbatueshëm procedural.